



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 407/3 Prot.

Tiranë, më 15.05.2023

V E N D I M

Nr. 73, Datë 15.05.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 61, datë 18.04.2023, të paraqitur nga z.S.M, kundër Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi parashtron se ka vite që sorrollatet nëpër dyert e gjykatave dhe burgjeve (Komisariati Nr.3). Ai deklaron se është i divorcuar që prej vitit 2014, ka dy fëmijë në moshë madhore të cilët jetojnë jashtë shtetit dhe prej vitesh jeton i vetëm.

Ankuesi parashtron se, problematika e tij lidhet me punonjësit e policisë pranë Komisarariatit Nr.3, në Tiranë, të cilët e arrestojnë dhe e mbajnë 12, 24, 48, 75 orë pa pa arsye. Një sjellje e tillë ka ndodhur disa herë, por hera e fundit që është arrestuar ka qenë në datë 05.02.2022. Ai shpjegon se, arsyeja e arrestimit të tij ka qenë një kallëzim që ka bërë shtetasi L.P, duke shpifur sikur ai kishte abuzuar me E.Gj (2 vjeçe e 6 muaj), e bija e shtetases V.Gj, me të cilët është komshi në një distancë prej 500 metra. Ankuesi shpjegon se kjo çështje është mbyllur me gjykata për mungesë provash.

Ankuesi thekson se ai nuk ka asnjë lidhje me këtë ngjarje, për më tepër me një fëmijë të vogël. Sipas tij arsyeja e të gjitha problemeve dhe arrestimeve të tij të shpeshta dhe pa arsye, është shtetasi Sh.P , i cili është oficer i policisë në Komisarariatin Nr.3.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Referuar materialit ankimor që ankuesi ka depozituar pranë komisionerit, ai pretendon se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur në datën 05.01.2000 dhe ka vazhduar deri në datë 05.02.2022, datë kjo kur ankuesi pretendon se ka marrë dënimin për situatën e pretenduar si diskriminuuese.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri marrjen e masave në mënyrë që policia të mos t'i paraqitet në derë pa arsye.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga ankuesi rezulton se, prej vitit 2015 ankuesi ka adresuar disa ankesa pranë institucioneve të ndryshme, si Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë (MD), Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP), Ministrisë së Brendshme (MB), Avokatit të Popullit (AP), duke pretenduar kryerjen e veprimeve të njëanshme, arbitrare dhe në kundërshtim me ligjin, nga ana e punonjësve të policisë së shtetit pranë Komisarariatit të Policisë nr.3, Tiranë. Disa prej problematikave të adresuara në korrespondencën që ankuesi ka mbajtur me autoritetet e mësipërme datojnë që prej vitit 2000 dhe kanë në bazë të tyre konflikte familjare që ankuesi pretendon se kanë lindur pas zgjidhjes së martesës me ish bashkëshorten e tij.

Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesi ka ngritur pretendime ndaj Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë, duke pretenduar se është arrestuar pa të drejtë nga ana e punonjësve të policisë në lidhje me një ngjarje të ndodhur në datën 05.02.2022. Sipas ankuesit, arsyeja e arrestimit të tij ka qenë një kallëzim që ka bërë shtetasi L.P, duke shpifur sikur ai kishte abuzuar me E.Gj (2 vjeçe e 6 muaj). Ankuesi shpjegon se kjo çështje është mbyllur nga gjykata për mungesë provash, por nuk ka depozituar ndonjë vendim gjykatë.

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga ana e ankuesit, rezulton se në lidhje me ngjarjen e datës 05.02.2022, ku ankuesi pretendon se është arrestuar me pa të drejtë nga ana e punonjësve të policisë pranë Komisarariatit Nr.3, Tiranë, ai ka paraqitur ankesë pranë AMP, AP, si dhe ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Veprimet dhe trajtimi i problematikës nga ana e këtyre institucioneve në lidhje me ngjarjen e datës 05.02.2022, e cila rezulton sipas akteve të administruara, paraqitet si më poshtë:

Me shkresën nr.S-8/3 prot datë 18.04.2022, AMP, pasi ka verifikuar pretendimet e ankuesit për shoqërim të padrejtë në datën 05.02.2022, nga punonjësit e policisë të Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë, ka arritur në përfundimin se, veprimet e kryera nga strukturat e policisë pranë këtij komisaritati, ishin kryer në përputhje me procedurat standarte të punës. Sipas kësaj shkrese rezulton se në datën 05.02.2022, ndaj ankuesit ishte bërë një kallëzim penal në Komisariatin Nr.3 Tiranë, për veprën penale “Vepra të turpshme”, parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal, dhe se ankuesi ishte shoqëruar për të dhënë deklaratën e tij para specialistes për hetimin e krimeve në këtë komisariat. Sipas shkresës së AMK, rezulton se, materialet procedurale në ngarkim të

ankuesit i janë refuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në datën 09.02.2022. Nga aktet e administruara nuk ka informacion nëse procedimi penal në ngarkim të ankuesit ka përfunduar dhe as për mënyrën e përfundimit të tij.

Pretendimet e tij për veprime të padrejta dhe në kundërshtim me ligjin nga ana e punonjësve të policisë në Komisarariat Nr.3, Tiranë, në lidhje me ngjarjen e datës 05.02.2022, ankuesi i ka paraqitur edhe pranë AP. Me shkresën nr.K 2/S3-2 prot datë 07.03.2022, AP ka filluar procedurën, duke kërkuar shpjegime nga Komisarati i Policisë Nr.3, Tiranë, në lidhje me pretendimet e ankuesit. Nga aktet e vendosura në dispozicion por edhe nga shpjegimet e dhëna në ankesë, ankuesi nuk jep informacion nëse procedurat pranë AP kanë përfunduar dhe përfundimet e arritura prej tij.

Në lidhje me ngjarjen objekt shqyrtimi, ankuesi ka paraqitur kallëzim penal nr.1487, datë 16.02.2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me pretendimin se ndaj tij janë kryer veprime arbitrare nga oficerët e policisë së Komisarariatit Nr.3, Tiranë dhe konkretisht nga oficeri i policisë Sh.P. Me vendimin e datës 21.02.2023, organi i prokurorisë ka vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin penal nr.1487, datë 16.02.2023, pasi pretendimet e ankuesit përbëjnë “gjë të gjykuar”. Referuar vendimit të mosfillimit të datës 21.02.2023 të organit të prokurorisë, rezulton se, të njëjtat fakte dhe rrethana, janë kallëzuar edhe më herët nga ana e ankuesit me disa kallëzime penale, konkretisht kallëzimet penale nr.847 viti 2022, nr.2200 datë 22.02.2022, nr.5699 datë 21.04.2022, nr.7045 datë 20.05.2022, nr.8537 datë 20.06.2022, kallëzime për të cilat prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimeve. Ankuesit i është komunikuar vendimi për mosfillimin e kallëzimit penal nr.1478 të vitit 2023, nëpërmjet shkresës nr.1487 prot datë 06.04.2023.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit, ankesën 61 regj., datë 18.04.2023 kundër Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë, duke pretenduar se është shoqëruar pa asnjë arsye nga punonjësit e policisë së këtij komisarati dhe se një sjellje e tillë përbën diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se :

“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose

grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkak të gjendjes ekonomike dhe gjendjes familjare, të pretenduara si shkaqe diskriminuese nga ankuesi.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrorë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Ankuesi nuk parashtron fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se veprimet arbitrare dhe shoqërimi i padrejtë i tij në datën 05.02.2022, nga ana e punonjësve të policisë

pranë Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë, të pretenduara nga ana e tij, bazohen apo kanë si shkak, gjendjen ekonomike dhe gjendjen familjare, të cilat ankuesi i ka pretenduar si shkaqe diskriminuese.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Në thelb pala ankuese ka ngritur pretendime për paligjshmëri të sjelljes nga ana e pononjësve të policisë pranë Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesi ka ngritur kundër Komisarariatit të Policisë nr.3, Tiranë, për sa kohë që ato nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi S.M kundër Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 61 regj., datë 18.04.2023, të paraqitur nga z. S.M kundër Komisarariatit të Policisë Nr.3, Tiranë,
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: “gjendja ekonomike”, “gjendja familjare”
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mospranim